



Nr. 02/6486/2018

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 68 Informimi Publik dhe Konsultimi, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit, neni 24 Tubimet me Publikun, Kryetari i Komunës fton qytetarët në:

Takimet konsultative rreth hartimit të Projekt – Buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2020-2021

Me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, siç është Projekt-Buxheti për vitin 2019 dhe parashikimet për vitet 2020-2021, Kryetari i Komunës fton qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit në takimet konsultative, duke filluar nga data 13-17 Gusht 2018 në lokacionet e shënuara më poshtë:

ORARI DHE VENDI I TAKIMEVE PËR DËGJIMET BUXHETORE ËSHTË SI VIJON:

- Me datën **13 gusht 2018 (e hënë)**, në ora **19:00**, në objektin e SHFMU. "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë, do të mbahet takim me banorët e fshatit Paldenicë, Ramukë dhe Dërmjak.
- Me datën **14 Gusht 2018 (e martë)**, në ora **19:00**, në objektin e SHFMU. "Ilaz Thaçi" në Krivenik do të mbahet takim me banorët e fshatit Krivenik.
- Me datën **15 Gusht 2018 (e mërkurë)**, në ora **19:00**, në objektin e SHFMU. "Ilaz Thaçi" në Seçishtë, do të mbahet takim me banorët e fshatit Seçishtë.
- Me datën **16 Gusht 2018 (e enjte)**, në ora **19:00**, në objektin e SHFMU. "Veli Ballazhi" në Gorancë, do të mbahet takim me banorët e fshatit Gorancë, Rezhancë dhe Lagjes Hunel.
- Me datën **17 Gusht 2018 (e premte)**, në ora **16:00**, në objektin e shtëpisë së kulturës "Imri Curri" në Han të Elezit, do të mbahet takim me qytetarët e Hanit të Elezit, fshatrat: Dimcë, Laç, Pustenik si dhe Lagjet: Lagja e Re, Uji i Thartë dhe Meliq.

Pjesëmarrja e juaj, të dashur bashkëqytetarë, do të jetë në funksion të dhënies së ideve dhe propozimeve për hartimin sa më cilësor të projekteve zhvillimore të Komunës së Hanit të Elezit dhe do të jetë mundësi që ju të jeni ata që do të vendosni për të ardhmen tuaj.

Me respekt,

Hani i Elezit

31/07/2018

